



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.379/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kaçanik Resul Lika, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Kaçanik, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** si e palejuar ankesa ZL.A.nr.379/2017, e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Kaçanikut, Resul Lika nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Kaçanik, e paraqitur me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Resul Lika, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Kaçanikut, nga radhët e subjektit politik PDK, me të cilat pretendon se tri Qenda të Votimit: në fshatin Glloboçicë, Bob dhe Begovc, i janë manipuluar dhe i janë bartur votat e tij kandidatit tjetër. Më tutje parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet verifikimi i këtyre Qendrave të Votimit.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkritazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar, mbi shpalljes e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë tjetër, pas publikimit të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL. Anr.379/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Rafet Haxhaj**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*